

VENDIM
Nr. 99/2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017 “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partive të Djathhta,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit të Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në Komisionin për Integrimin Evropian caktohen anëtarë deputetja Edlira Hyseni (GP) dhe deputeti Kostaq Papa (GPDj).
2. Në Komisionin për Politikën e Jashtme caktohen anëtarë deputeti Taulant Balla (PS) dhe deputetja Edjola Braha (GP).
3. Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat caktohet anëtar deputeti Ylli Shehu (GP).
4. Në Komisionin për Sigurinë Kombëtare caktohet anëtar deputeti Nimet Musaj (GP).
5. Në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik caktohet anëtare deputetja Amra Barova (GP).
6. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktohet anëtar deputeti Nikolin Staka.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 12.9.2019